



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 117/5 Prot.

Tiranë, më 07.06.2021

V E N D I M

Nr.65, datë 07.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë gjatë periudhës së provës, dhe vendimit nr. 01, dt. 02.07.2020 të Komisionit të Disiplinës për dhënien e masës “Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë 2 mujore”, për nëpunësen ***, me detyrë “Specialist në Sektorin e Financave”, në Drejtorinë Vendore të Policisë, Lezhë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, procedurën disiplinore, etj, për nëpunësen *****, me detyrë “Specialist në Sektorin e Financave”, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

Vërej se:

Nëpunësja civile ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 117 prot., datë 03.02.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara nga institucioni Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, që vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, gjatë veprimeve të kryera në lidhje me procesin vlerësimit të rezultateve në punë në fund të periudhës së provës dhe zhvillimin e një ecurie disiplinore e cila ka përfunduar nëpërmjet vendimit nr. 1 dt. 02.07.2020 të Komisionit Disiplinor, me marrjen e masës

disiplinore “Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë 2(dy) mujore”, të cilat mund të ndikojnë në moskonfirmimin e saj si “nëpunës civil”.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, si dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 117/1 prot., datë 15.02.2021, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e kërkesës së nëpunësit civil në periudhë prove *****, për rregullshmërinë e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës”, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ka njoftuar fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së këtij rasti, duke kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen hetimit administrativ. Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, me shkresën nr. 849/1 prot., datë 02.03.2021, “Kthim përgjigje”, ka vënë në dispozicion gjithë praktikën e kërkuar në lidhje me veprimet administrative të kryera.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të administruara në kuadër të këtij hetimi administrativ, rezulton e vërtetuar se ankuesja *****, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 718 prot., datë 04.02.2020, të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Finacave”, akt i cili është pasuar me Urdhrin nr. 206/3, datë 03.03.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, që ka shënuar fillimin e marrëdhënieve të punës.

Në lidhje me pretendimin, se ndaj saj është zhvilluar një ecuri e padrejtë disiplinore, e cila ka përfunduar me marrjen e masës disiplinore “Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë 2(dy) mujore”, konstatohet që nëpunësja *****, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, (kërkesë padia me nr. 47619, me datë regjistrimi nr. 21.09.2020), prandaj u vlerësua që për këtë pjesë të procesit, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk duhet të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, të vendoset përfundimi i hetimit administrativ dhe arkivimi i çështjes, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Pretendimi tjetër i ngritur nga nëpunësja në fjalë, lidhet me parashtrimin e disa parregullsive të kryera gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, që vijnë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Pasi u administrua dhe shqyrtua dokumentacioni i nevojshëm, është konstatuar që në datën 22.09.2020, (gjashtë muaj nga data e emërimit në pozicionin e punës), është kryer një

vlerësim 6-mujor i punës për nëpunësen në periudhë prove *****, pa u përfunduar periudha njëvjeçare e provës.

Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, është i rregullt nga pikëpamja formale, i nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*), dhe vlerësimi përfundimtar është në **nivelin 4**, “*Jo kënaqshëm*”, gjë e cila prezumon se mund të sillte moskonfirmimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë punonjëse.

Akti i mësipërm i vlerësimit është i paligjshëm, *së pari*, sepse vjen në kundërshtim me urdhërimin e pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se periudha e provës, është një vit dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë.

Në përfundim të afatit një vjeçar të periudhës së provës, nëpunësi i nënshtrohet vlerësimit të punës, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 62, të ligjit të sipërpërmendur dhe Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar ky, me VKM nr. 252, datë 30.03.2016.

Sipas pikës 12, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, ashtu si edhe vlerësimi i punës në fund të periudhës së provës, duhet të kalojë në fazat e mëposhtme:

- *Planifikimi*, ku zyrtari raportues (*i cili, si rregull, është edhe eprori direkt*) takohet me nëpunësin civil që do të vlerësohet për të caktuar objektivat kryesore të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në këtë fazë zyrtari raportues së bashku me nëpunësin në provë, që do të vlerësohet diskutojnë qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- *Bisedimet e ndërmjetme*. Kjo fazë konsiston në takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku zyrtari raportues takohet me nëpunësin civil dhe vlerëson progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara dhe përmirësimet e nevojshme, në planin e hartuar me shkrim.
- *Vlerësimi përfundimtar*, i cili realizohet në përfundim të vitit të provës e që konsiston në vlerësimin e përmbledhur të nivelit të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet, në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Shkelja e kryer në këtë rast, duke vlerësuar nëpunësin 6 muaj para përfundimit të periudhës së provës, është e natyrës që mund të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e konkluzioneve të pasakta në lidhje me aftësitë e nëpunësit. Prezumohet që nëpunësi në provë, në pjesën e dytë të periudhës së provës, vjen duke u përshtatur dhe përfeksionuar më mirë në lidhje me ambientin e punës, me detyrën dhe vlerësimi i bërë përpara kohe, passjell jo vetëm pasaktësinë në vlerësimin e aftësive të nëpunësit, por mund të ndikojë edhe në formë paragjykimi, në kryerjen e vlerësimit përfundimtar.

Nga këqyrja e formularit të vlerësimit për periudhën 09.03.2020-09.09.2020, konstatohet që rubrikat janë të plotësuara me komente mjaft negative, por nga përmbajtja e këtyre komenteve, mund të arrihet në përfundimin se eprori direkt i nëpunëses ***** , ka marrë pozicionin e një gjykuesi dhe vlerësuesi të jashtëm, pa e ndjerë përgjegjësinë si drejtues i njësisë organizative dhe i nëpunësit, i cili ka për detyrë të bëjë përpjekjet e duhura për ta ndihmuar nëpunësin në provë të përshtatet me punën dhe ambientin e punës, si dhe të përmirësojë vazhdimisht cilësitë e tij.

Në dokumentacionin e procesit të mësipërm të vlerësimit, nuk ka të dhëna në lidhje me plotësimin nga ana e eprorit direkt dhe njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, të detyrimit të përcaktuar në pikën 9, të Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, për caktimin e një nëpunësi civil me eksperiencë nën kujdesin e të cilit duhet të ishte vendosur nëpunësi civil në periudhë prove.

Në rastin konkret, eprori direkt i ankueses kishte për detyrë që nëpunësen në provë, jo vetëm ta ngarkonte me punë, por edhe të ndiqte e orientonte në vazhdimësi atë, për mënyrën e kryerjes së detyrës dhe të kujdesej për mbarëvajtjen e saj. Të njëjtin kujdes duhej të tregonte edhe për kryerjen e detyrës nga ana e nëpunësit kujdestar, i cili duke e këshilluar rast pas rasti duhej të realizonte edhe dokumentimin, me shënime apo prova të tjera, në lidhje me ecurinë e nëpunëses në periudhë prove, evidentimin e mangësive dhe arritjeve, udhëzimet që i janë dhënë, periudhën kohore kur janë dhënë këto udhëzime apo orientime, vështirësitë apo problematikat e hasura gjatë kryerjes së detyrave funksionale, etj., veprime këto të cilat do të ndihmonin në arritjen e një vlerësimi përfundimtar, objektiv, transparent dhe të bazuar në prova.

Ndërkaq, gjatë kryerjes së këtij hetimi administrativ, mësohet se nëpunësja ***** , megjithë vlerësimin negativ 6 mujor, ka arritur të kryejë me vlerësim maksimal, programin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë në Shkollën e Administratës Publike (ASP), si detyrim i përcaktuar në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se procesi i vlerësimit 6-mujor të nëpunëses ******, gjatë kryerjes së periudhës së provës, bazuar në pikën d) të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është një veprim administrativ i paligjshëm, i cili në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit 113, të ligjit në fjalë, duhet të anulohet, duke lejuar nëpunësen të kryejë dhe përfundojë periudhën e provës, në plotësim të gjithë detyrimeve të cilat u përmendën në pjesën e sipërme të vendimit.

Në kushtet që ky rast është menaxhuar në kundërshtim me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, duhet të mbahet parasysh edhe ndikimi negativ i këtij procesi të paligjshëm, në psikologjinë e nëpunëses, e cila e vënë nën këtë lloj presioni nga ana e zyrtarëve raportues, konfirmues dhe autorizues, ka shumë mundësi të mos arrijë rezultatet e pritshme në punë, prandaj sugjerojmë që të shihet edhe mundësia e zbatimit të pikës 3/b të nenit 24, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, për ti dhënë asaj kohën e duhur për të gjetur qetësinë e nevojshme, për arritjen e rezultateve të kërkuara.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në nenin 90, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, pika 6, e 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, të kryer për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit 6-mujor të nëpunëses ******, dhe meqënëse vlerësohet se ai është një proces administrativ i paligjshëm, të kërkohet nga njësia e burimeve njerëzore që të ndjekë procedurën për anulimin e aktit të vlerësimit për periudhën 09.03.2020-09.09.2020, nga ana e zyrtarëve raportues, konfirmues dhe autorizues, si dhe heqjen e aktit të mësipërm të vlerësimit nga dosja e personelit.

Të vazhdojë kryerja e periudhës së provës për nëpunësen në periudhë prove ******, duke mbajtur parasysh gjithë sa është thënë në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

2. Përfundimin e hetimit administrativ të kryer për vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit nr. 01 dt. 02.07.2020, të Komisionit të Disiplinës, për marrjen ndaj nëpunëses ******, të masës disiplinore “Mbajtja e 1/3 të pagës së plotë, për një periudhë

2(dy) mujore”, dhe meqënëse rasti është duke u shqyrtuar nga organet gjyqësore, arkivimin e çështjes.

3. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, njësia e burimeve njerëzore e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse dhe kërkuesja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha